



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 03

Datë: 10. 04. 2019. Ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Stevan Veselinoviq, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ:

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-se nr. 01, dhe 02/2019.*
 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacinal për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Leptosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datë 19 maj 2019.
 3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale në Prizren, Deçan, dhe Mitrovicë e veriut, Junik, Viti.
 4. Formimi i Këshillave të KQZ-së.
 5. Vendim për shpalljen e konkursit për pozitat e lira në Sekretariat të KQZ-së (**shtyhet për mbledhjen e radhës...**)
 6. Të ndryshme.
-

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.

Valdete Daka: Përhëndetje. Kjo është mbledhja e tretë. A ka dikush ndonjë propozim lidhur me këtë rend dite...?

Adnan Rrustemi: Lidhur me pikën e pestë (Vendim për shpalljen e konkursit për pozitat e lira në Sekretariat të KQZ-së...), unë të paktën, po e shoh që nuk ka material të bashkangjitur.... E kam parasysh ngarkesën, mirëpo kërkoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Le të përgatitet material, dhe jo vetëm kështu, por të na silltet material më i detajuar, të përgatiten kriteret që i parasheh edhe rregullorja...

Sami Hamiti: Kolegu ka të drejtë që thotë se mungon materiali, por ne po merremi qe pesë vite me këtë punë...Është e vërtetë që, tash jemi në situatë tjetër, mirëpo ata që është dashur me u marrë nuk janë marrë... Mbas aprovimit të rregullores, kjo nuk është çështja e jonë fare...Mirëpo, ne duhet të shohim se si po zbatohen rregulloret që, vetë i kemi aprovuar...E, kjo temë po hapet për atë që, këtu qe pesë vite nuk është aprovuar...

Adnan Rrustemi: Rreth përmbajtjes unë kam qëndrim, dhe e kuptoj që është nevojë urgjente...Mirëpo, mendoj që kjo çështje pret deri në mbledhjen e radhës, sepse nuk kemi informacion...Në aspekt tjetër, unë do të mbaj qëndrim rreth përmbajtjes së kësaj pike...

Valde Daka: Nuk ka edhe se çka shtohet, sepse mundet me u shtua përmbajtja...Unë, më shumë e kam futur këtë pikë sepse, tashmë disa vende janë qe katër gjashtë vite dhe nuk janë implementu, kurse tash kemi edhe disa vende për kryesues të KKZ-ve...

Ercan Spat: Rregullorja parasheh se si planifikohen mbledhjet, ndërsa ne në kohë të zgjedhjeve jemi vazhdimisht në mbledhje... Po pajtohem me të dy kolegët, por ne duhet të merremi me ata që nuk janë marrë me këto probleme...Unë, mendoj që edhe rreth formimit të këshillave të kemi konsultim paraprak...

Valdete Daka: E kam futë në agjendë edhe çështjen e këshillave, sepse ne duhet të fillojmë...mirëpo, pa e futur në agjendë ne s'kemi si të merremi...

Florian Dushi: Meqë, është kohë e gjatë dhe këto pika nuk janë përmbushë, unë pajtohem se nuk është aq shumë problem që dy – tri ditë të shtyhet deri sa, dikush ta kompletoj materialin...Këtu u tha se, "...KQZ duhet, jo nuk duhet... etj.", mirëpo KQZ duhet ta detyroj Sekretariatit që ta përmbush një obligim që nuk e ka përmbush me vite të tëra...Sepse, për asnjë pozitë vakante, dhe për asnjë pozitë tjetër që edhe me shumë mund dikur i kemi pas fituar, nxjerrë gjatë debateve me komisionet relevante...Mendoj që, duhet të vendosim dhe më në fund, duhet ta detyrojmë Sekretariatit sepse disa KKZ ta zëmë, tashmë nuk janë funksionale...Dhe kjo, është një papërgjegjësi totale...

Vetë po sponsorizohen shkrimet e debatet në opinion, rreth KQZ-së...

Adnan Rrustemi: Unë, e kam marrë materialin vetëm një orë para zgjedhjes...! Nuk e di për tjerët, por s'kemi qenë në dijeni të agjendës së kësaj mbledhjeje...Duhet të diskutojmë, mund të kemi mendime të ndryshme etj., mirëpo nuk ka asnjë justifikim që këto pozicione mbeten kështu vakante...Pastaj, janë dy pozita që janë komplet kompetencë e KQZ: pozita e Zëvendës kryeshefit dhe e Drejtorit të ZRPPP...

Valdete Daka: Agjenda e kësaj mbledhjeje, pothuajse është përgatitur një ditë para shpalljes së zgjedhjeve...Ne, edhe mund ta heqim...por, këto janë pozita të lira...S'kemi çka të diskutojmë. Për shembull, pozitat e kryesuesve të KKZ-ve dhe këto nuk janë dëshira...! Nuk ka problem, e shtyjme por, s' duhet të humbim kohë...

Adnan Rrustemi: Për dy pozitat e para, le të na përgatiten aktvendimet nga Sekretariati, s'kemi fare çka presim...! Për dy pozicionet, e për të tjerat diskutojmë....

Valdete Daka: Po e shtyjme këtë pikë...! Atëherë, kush është për këtë rend dite, kuptohet pa pikën e pestë...?

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-se nr. 01, dhe 02/2019.

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ miratuan procesverbalet nga mbledhjet e KQZ-së: nr. 01 dhe 02/2019.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacinal për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Lemosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datë 19 maj 2019.

Valdete Daka: E keni para vetes Planin Operacinal me specifikat e veta...

Adnan Rrustemi: Nëse ka mundësi, meqë është drejtor i DOZ-it..., që ai të na informoj më konkretisht...Ky është plan zgjedhor... Le të na konfirmoj drejtori rreth afateve, e që janë të konfirmuara në mbledhjen e mbajtur për shkurtim të afateve....dhe, të specifikave të tjera sepse, kjo ju duhet anëtarëve të KQZ-së, dhe se, ne e kemi të pamundur që këtu nën aktivitetet t'i analizojmë dhe ti harmonizojmë...! Le të na konfirmoj drejtori...

Haki Krasniqi, drejtor i DOZ-it: Planin e keni, dhe aktivitetet janë të bazuara mbi vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për shpalljen e këtyre zgjedhjeve që të mbahen më 19 maj 2019, dhe mbi bazën e Vendimit të KQZ të mbledhjes së KQZ-së të mbajtur më datës 8 prill, 2019 lidhur me vendimin për shkurtimin e afateve zgjedhore...

I gjithë plani i parashev afatet, pra periudhat për implementimin e zgjedhjeve. Planin, është i realizuar prej të gjitha njësive të Sekretariatit, dhe është i gatshëm për miratimin tuaj...

Valdete Daka: E, rezervojmë të drejtën që nëse plani ka ndonjë gabime, eventualisht, të përmirësohet në ndërkohë... Nëse nuk ka askush tjetër për të diskutuar, kush është për miratimin e këtij plani...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Planin Operacinal për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunitet Lemosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datë 19 maj 2019.

Urdhërojmë Sekretariatit që ky plan, menjëherë të publikohet në Ueb faqen tonë...

4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale në Prizren, Deçan, dhe Mitrovicë e veriut, Junik, Viti.

Xhemajl Peqani, drejtor i Zyres Ligjore: Përshëndetje, përpara keni materialin e tërësishëm për zëvendësime nga gjashtë komuna. E para, znj. Elisa Karaxhi, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Prizren nga subjekti politik “Koalicija Vakati”, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Memnuna Ajdini. Pastaj,

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

Xhemajl Peqani, drejtor i Zyres Ligjore: Kërkesa e dytë, po ashtu është nga Kuvendi Komunal i Prizrenit...! Kështu, z. Getoar Besimi, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prizren nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës-PDK” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Skender Sallauka.

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

Xhemajl Peqani, drejtor i Zyres Ligjore: z. Ilir Ferizaj emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Deçan nga subjekti politik “Lëvizja Vetëvendosje” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Kastriot Lokaj.

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

Xhemajl Peqani, drejtor i Zyres Ligjore: z. Igor rajčić emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut nga subjekti politik “GI SDP- Oliver Ivanović” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Marko Jakšić.

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

Xhemajl Peqani, drejtor i Zyres Ligjore: z. Ramadan Deliu emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Viti, nga subjekti politik “Lidhja Demokratike e Kosovës- LDK” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Afrim Ramushi.

Valdete Daka: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

Xhemajl Peqani, drejtor i Zyres Ligjore: E kemi edhe një kërkesë nga komuna e Junikut...! Në fillim, kërkesa ishte e pakompletuar, mirëpo tani është e kompletuar. I njëjti, asamblisti nga Lëvizja “VETËVENDOSJE” që konsiderohej se kishte munguar tri herë pa arsye, ka sjellë vërtetimin që ka pasur probleme shëndetësore. Dhe ne, konsiderojmë që ky zëvendësim nuk duhet të bëhet, sepse asamblisti e ka arsyetuar mos pjesëmarrjen në mbledhjet e Kuvendit Komunal.

Valdete Daka: Ne, në fakt i bie që duhet ta refuzojmë këtë kërkesë...!

(Këtë refuzim, e arsyetuan edhe anëtarët: Adnan Rrustemi dhe Sami Hamiti)

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

4. Formimi i Këshillave të KQZ-së

Pas debatit të gjerë rreth kësaj pike, anëtarët e KQZ-së vendosen që kjo pikë të shqyrtohet menjëherë pas përfundimit të mbledhjes, të caktohen anëtarët e këshillave dhe, në mbledhjen e radhës të miratohet përbërja e këshillave...

